



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**  
*Qeveria*  
*Vlada-Government*  
*Ministria e Zhvillimit Ekonomik*  
*Ministarstvo Ekonomskog Razvoja-Ministry of Economic Development*

**Departamenti i Financave dhe Shërbimeve të Përgjithshme /Department za Finansije i Opšte Usluge /Department of Finance and General Services**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik duke u bazuar në Ligjin për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës L. Nr. 03/L-149 dhe Rregulloren nr. 02/2010 për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës bënë:

**SHPALLJEN E REKRUTIMIT**

**Departamenti i Minierave - Divizioni i Politikave Minerare**

**Numri i Konkursit: APF0002283**

**Vendi i punës: Udhëheqës i Divizionit të Politikave Minerare EZHE/060 / JP00029758**

**Koeficienti : 9.00**

**Kohëzgjatja e Emërimit: Dy (2) Vjeçare**

**Mbikëqyrësi: Drejtori i Departamentit të Minierave**

**Detyrat dhe përgjegjësitë:**

- Udhëheq procesin e hartimit dhe rishikimit të dokumenteve të politikave/strategjive në sektorin minerar;
- Propozon, harton dhe monitoron zbatimin e legjislacionit për sektorin minerar;
- Harton raporte të rregullta periodike mbi zbatimin e Strategjisë Minerare dhe legjislacionit për sektorin minerar;
- Harton dhe monitoron planet për zhvillim të komuniteteve të ndikuara nga aktivitetet minerare;
- Ofron mbështetje në shqyrtimin dhe propozim-miratimin e Planit të Menaxhimit të resurseve minerale;
- Shqyrton planet hapësinore lidhur me menaxhimin e resurseve minerale.

## **Kualifikimi i nevojshëm :**

- Diplomë Universitare nga lëmia e Gjeoshkencave në drejtimet: Gjeologji, Xehetari, Metalurgji
- 5 vite përvojë pune profesionale;
- Aftësi menaxheriale dhe punë ekipore;
- Aftësi në ndërmarrjen e iniciativave;
- Njohuri e legjislacionit përkatës vendor dhe ndërkombëtar për lëmin e xehetarisë, përpunimit, shfrytëzimit dhe plasmanit të produkteve minerale;
- Aftësi të avancuara me kompjuter MS Windows, MS Office (Word, Exel, Power Point, Project, Outlook);
- Aftësi komunikimi (shkrim dhe prezantim oral) në gjuhën Shqipe ose serbe, njohja e gjuhës angleze është përparësi,
- Aftësi të punon në mënyrë efektive në mjedisin multi-etnik dhe multi-kulturor;
- Aftësi të punon në nivelin më të lartë të konfidencialitetit dhe transparencës;

## **Procedura e konkurrimit**

Procedura e konkurrimit është e hapur për kandidatë të jashtëm si dhe nëpunës civil ekzistues të cilët i plotësojnë kriteret e konkursit. Kërkesa për punësim dhe përshkrimi i punës mund të merret në recepcionin e ndërtesës së Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik (Sheshi Nëna Terezë, Toskanë, Prishtinë) Formularin zyrtar për aplikim, mund ta gjeni edhe në Web faqen <http://mzhe.rks-gov.net> .

Aplikacionit duhet ti bashkëngjiten dokumentet përcjellëse si vijon: Formulari i plotësuar i aplikimit, dëshminë për kualifikimet arsimore dhe profesionale (diplomat e fituara jashtë vendit duhet të jenë të nostrifikuara nga MASHT-i), dëshminë e përvojës së punës, dy referenca.

Përdorimi i formularit të gabueshëm dhe ai i pakompletuar me të dhënat e kërkuara do të konsiderohet i pavlefshëm. Kërkesat dorëzohen në Zyrën e Arkivës, kati I-rë, ndërtesa e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik ose me postë.

## **Informatë e përgjithshme për të gjithë kandidatët**

Ministria e Zhvillimit Ekonomik , ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Kosovës dhe mirëpret aplikacionet nga të gjithë personat e gjinisë mashkullore dhe femërore nga të gjitha komunitetet në Kosovë. Komunitetet jo shumicë kanë të drejtë për përfaqësim të drejtë dhe proporcional në organet e shërbimit civil siç specifikohet në nenin 11, paragrafi 3 të Ligjit Nr. 03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës. Kohëzgjatja e kontratës sipas LSHC, duke përfshirë periudhën e punës provuese.

Për shkak të numrit të madh të kërkesave të pranuar, vetëm kandidatet e përzgjedhur në listën e ngushtë do të kontaktohen.

**Afati i konkurrimit është prej datës 03 /07/2017 deri me date 17/07/ 2017, deri në orën 16:00.**

**Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e publikimit në shtypin ditor.**

Kërkesat e dërguara pas datës së fundit të konkurrimit nuk do të pranohen. Për informata shtesë, ju lutemi telefononi në numrat: 038 200 21524